



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18.3.2023

Nr: 179

Ora: 11.00

VENDIM

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 27, DATË 16.3.2023, TË KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE, PËR REGJISTRIMIN E "PARTISË DEMOKRATIKE" SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë, 18.3.2023 në seancë publike, pasi u njoha me vendimin nr. 27, datë 16.3.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

VËREJ:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me shumicë votash ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore me nr. 33 të ankuesit "Partia Demokratike", përfaqësuar në seancë nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri.
2. Pranimin e pjeshëm të kërkesës ankimore nr. 32 të ankuesit "Partia Demokratike", përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa.
3. Detyrimin e partisë "Partia Demokratike", të depozitojë në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë vijon:
 - Deklaratën sipas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
 - "Deklaratën e angazhimit solemn" të nënshkruar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë.
4. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor "Partia Demokratike" me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë.

Data: 18.3.2023 Nr. 179
Ora: 11:00



Mbi zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për regjistrimin e "Partisë Demokratike" si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, "Partia Demokratike" me shkresën nr. 1337/1 Prot., datë 17.3.2023, ka paraqitur në KQZ:

1. Deklaratën me të dhënat e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, të kërkuar në pikën 3, të vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të KAS-it.
2. Deklaratën Solemne të nënshkruar nga z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, të kërkuar në pikën 3, të vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të KAS-it.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Regjistrimin e partisë politike "Partia Demokratike", me shkronja nistore "PDSH", me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI